

Monitorimi i Porosive
AvRest Member
AvRest Web
AvRest Monitor
Pershtatshmeria me Printer Fiskal

€ 300,00

mbi 300 referenca

Monitorimi i Porosive
Member
Web
Monitor
Pershtatshmeria me Printer Fiskal



Restaurant Management Studio

ab 7% Zins + Swiss Capital Kredit

KREDI
250'000.-




Reklamo këtu!

SHKURT ▾

Francezët kundërsulmojnë Ajaksin

- Home
- Bota
- Kosova
- Shqipëria
- Maqedonia
- Aktuale
- Lajme
- Sporti
- Ekonomia
- Opinione
- Kronikë e Zezë
- Intervista
- Kultura
- Diaspora
- Shtypi botëror
- Mediale & Vip
- Këndi i Biznesit
- Dokumentare
- Bota e Yjeve
- Speciale
- Reportazhe
- Teknologjia
- Shëndetësia
- Lifestyle
- Hiti i ditës
- Tour de France 2011
- Sport plus
- Ndryshe
- Njoftime për të pame
- Përkujtime
- Ngushëllime
- Na Kontaktoni

Kohl, kancelari i bashkimit të Gjermanisë dhe vizionari i Evropës së bashkuar

Xhevat Ukshini

Ambasadori i Kosovës viziton kancelarin Helmut Kohl në Ludwigshafen

Ambasadori i Kosovës në Berlin, dr. Vilson Mirdita, javën që shkoi e vizitoi në shtëpinë e tij në Ludwigshafen kancelarin historik gjerman dr. Helmut Kohl, një vizitë kjo padyshim e rëndësishme për simbolikën e mesazhin e saj politik që bart.

Të takosh njeriun që me vendimet e tij la gjurmë të pashlyeshme në historinë moderne të kombit gjerman, duke realizuar ëndrrën e tij të bashkimit kombëtar, është pa kurrëfarë dyshimi një nder i madh për ambasadorin e shtetit më të ri të Evropës, për ekzistencën e të cilit duhet "të fajësohet" edhe politika gjermane e kohës së Kohl-it dhe tani kjo e dr. Angela Merkel-it, qeveria e të cilës të premtën e kaluar e ndëshkoi Serbinë në Këshillin e BE-së në Bruksel pikërisht për shkak të politikës së saj destruktive ndaj Kosovës. Të takosh njeriun që me politikën e tij largpamëse i dha shtysë të fuqishme bashkimit politik të Evropës dhe kahje thellësisht paqësore rrjedhës së historisë së kontinentit tonë, është një mundësi e rrallë. "Bashkimi gjerman dhe bashkimi evropian ishin për mua dy faqe të së njëjtës medalje" ka shkruar Kohl në kujtimet e tij. Me iniciativën gjermano-franceze u fut monedha e përbashkët evropiane euro dhe unioni politik i Evropës shkoi paralelisht me proceset integruese brendagjermane. Gjithë kjo ishte meritë e padiskutueshme e kancelarit Helmut Kohl. Duke i njohur këto fakte dr. Vilson Mirdita ishte i ndërgjegjshëm se vizita tek "Qytetari i nderit i Evropës" Helmut Kohl, titull ky që i është dhënë para tij vetëm edhe Jean Monnet-it, përbente një privilegj tepër të madh. Edhe presidenti historik i Kosovës dr. Ibrahim Rugova në vitin 2004 e nderoi kancelarin gjerman me "Medaljen e Artë të Lirisë".

Në bisedën me dr. Mirditën kancelari Kohl i vlerësoi lart përpjekjet e popullit të Kosovës për të qenë i lirë dhe ndërtuar shtetin e vetë demokratik, por Ai në të njëjtën kohë vuri në dukje edhe mungesën e vizionit për të përfunduar, siç tha Ai, projektin e Evropës së bashkuar, ku vendet e Ballkanit Perëndimor doemos do të ishin brenda saj qëkur, sepse ato aty e kanë vendin. Ambasadori Mirdita e informoi gjerësisht kancelarin Kohl për arritjet, por edhe për sfidat me të cilat ballafaqohet populli dhe rinia e Kosovës. Njëra nga temat e bisedës ishte natyrisht edhe arsimimi i gjeneratës së re. Puna e gjimnazit „Loyola“ në Prizren u vlerësua si një shembull i bashkëpunimit të mirëfilltë gjermano-kosovar, një projekt i realizuar me sukses në këtë fushë kaq të rëndësishme për të ardhmen e vendit tonë.

Një përshkrim të veçantë kancelarit Kohl i bëri libri „Kosovo-Kosovo NewBorn“ me pamjet e rinisë së Kosovës plot jetë saqë Ai në një moment tha se me gjithë dëshirë do ta kishte vizituar Kosovën. Ambasadori Mirdita i dhuroi mikpritësit të tij edhe një shtatore të Nënës Tereze dhe një hartë të Kosovës me mineralet nga nëntoka e saj e pasur. Kancelari Kohl duke ju falënderuar mysafirrit te tij për këto dhurata domethënëse, ndër të tjera tha se "një popull që i ka dhënë botës një personalitet të tillë si Nëna Terezë, me të cilën jam takuar edhe personalisht, padyshim që ka një perspektivë të ndritshme."

Në takimin që zgjati rreth dy orë ishte prezent edhe deputeti i CDU-së në Bundestag, z. Philip Missfelder, i cili në fraksionin së partisë së tij qeveritare e mban postin e zëdhënësit për politikë të jashtme. / Xhevat Ukshini


















Ambasadori i Kosovës viziton kancelarin Helmut Kohl në Ludwigshafen

Bota Sot auf Facebook

Gefällt mir

7,760 Personen gefällt **Bota Sot**.

 Aliu	 Euro	 Gazmend
 Bujar	 Floriana M.	 Shpend
 Ridvan	 Gjoni	 Fisnik Fizz
 Shefqet	 Halim	 GenTozz
 Granit	 Vildane	 Valbon

Soziales Plug-in von Facebook

SF METEO



Doli në shitje numri më i ri i Revistës Kosovarja në Diasporë